

Për më shumë informacione

Emërtimi: Zyra e Projektit
Adresa: Rr. "Zlatko Shnajder" nr.6A/3, 1000 Shkup
tel.: +389 2 227720
Faks: +389 2 227720
E-posta: info@pacs-mk.eu

Emërtimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Adresa: Rr. "Dame Gruev" nr.14, 1000 Shkup
Tel.: +389 2 3106212
Faks:
E-posta: mtsp@mtsp.gov.mk
Ueb-faqja: www.mtsp.gov.mk

Këtë Projekt e zbaton WYG International LTD (UK) në konzorcium me ESEP LTD (UK) dhe WYG Consulting (HR). Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Komisionit Evropian.

Bashkimi Evropian përbëhet nga 27 vende-anëtare të cilat vendosën gradualisht t'i ndërlidhin njohuritë, resurset dhe fatet e tyre. Bashkërisht, në periudhën 50 vjeçare të zgjerimit, të njëjtat e ndërtuan zonën e stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, njëkohësisht duke e ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale.

Bashkimi Evropian është përkushtuar për t'i ndarë arritjet dhe vlerat e veta me vendet dhe popujt jashtë kufijve të tij".

Komisioni Evropian është organi ekzekutiv i BE.



Ky Projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



Programi operativ "Zhvillimi i resurseve njerëzore"
2007-2013

Promovimi i shërbimeve për përkujdesjen alternative të fëmijëve



Projekt i implementuar nga WYG International Ltd në konzorcium me ESEP Ltd dhe WYG Savjetovanje doo

Promovimi i shërbimeve alternative për përkujdesjen e fëmijëve

Rezultate të pritshme nga Projekti

Pritet që ky Projekt të arrijë katër rezultate kryesore.

1. Do të vlerësohet dhe analizohet aksesin e shërbimeve ekzistuese për përkujdesjen e fëmijëve, si dhe kërkesa për shërbime alternative për përkujdesjen e fëmijëve.
2. Shërbimet ekzistuese për përkujdesje do të përmirësohen dhe do të projektohen, do të testohen dhe inkuororohen shërbime fleksibile, të aksesshme dhe cilësore për përkujdesjen alternative të fëmijëve, duke krijuar kushte për zhvillimin e karrierës së prindërve të fëmijëve.
3. Dhënësit potencialë të shërbimeve për përkujdesjen e fëmijëve do të fuqizohen me udhëzime, këshillime, trajnime, kualifikime, mentorime dhe me shtigje për krijimin e bizneseve.
4. Ndërgjegjësimi i politikave për pajtim do të rritet midis punëdhënësve të cilët po ashtu do të stimulohen që t'i mbështesin të punësuarit e tyre në mënyrë që ta kombinojnë punën dhe jetën familjare.



Qëllimi dhe dedikimi i Projektit

Projekti ka për qëllim ta përmirësoj aksesin në punësim për të gjithë. I njëjti ka për qëllim të rritet pjesëmarrja dhe progresi i prindërve me fëmijë në procesin e punësimit përmes përmirësimit të mjedisit nacional të punës.

Qëllimi i drejtpërdrejt i këtij Projekti është të përmirësohet punësimi i prindërve, i nënave e baballarëve me fëmijë, përmes promovimit, zhvillimit dhe ofertës së shërbimeve alternative për përkujdesjen e fëmijëve.



Promovimi i shërbimeve alternative për përkujdesjen e fëmijëve

Qeveria e ka identifikuar harmonizimin e punës dhe jetës familjare, dhe veçanërisht kujdesin për fëmijët, si një instrument për përmirësimin e aksesit në punësim për prindërit me fëmijë dhe për avancimin e barazisë gjinore, politikave demografike dhe politikave për mbrojtjen e fëmijëve. Për këtë qëllim filloi Projekti: "Promovimi i shërbimeve alternative për përkujdesjen e fëmijëve". Projekti përbëhet nga 3 komponentë:

Komponenti 1 është një nga aktivitetet kryesore hulumtuese që fokusohet mbi analizën e aksesit të shërbimeve ekzistuese për përkujdesjen e fëmijëve dhe kërkesa për forma të shërbimeve alternative plotësuese dhe fleksibile për përkujdesjen e fëmijëve në mbarë vendin.

Komponenti 2 qëllime të fokusuara mbi zhvillimin dhe inkuororimin e një sërë shërbimeve fleksibile, cilësore dhe me kosto të aksesshme për përkujdesjen e fëmijëve brenda vendit, me synim që t'u ofrohet mbështetje prindërve me fëmijë në harmonizimin e detyrave të punës dhe kujdesit për fëmijët.

Komponenti 3 ka për qëllim t'i stimulojë punëdhënësit që t'u ndihmojnë të punësuarve të tyre ta kombinojnë punën dhe jetën familjare.

Projekti: "Promovimi i shërbimeve alternative për përkujdesjen e fëmijëve" u disenjua në kuadër të Programit për ndihmë para-aderuese në Bashkimin Evropian për vendin-përfitues, Komponenti IPA IV.

Projekti filloi në muajin shkurt të vitit 2015 dhe do të implementohet në periudhën kohore prej 24 muaj.

